



Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit bazik Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Ligjin Nr. 04/L-223, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr:

## VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 05/2016

### DETYRIMI PËR TË PAGUAR TVSH-NË PËR FURNIZIMIN E SHËRBIMEVE NË LËMIN E NDËRTIMIT – APLIKIMI I NGARKESËS SË KUNDËRT

#### QËLLIMI

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është të sqaroj trajtimin tatimor për aspekte të TVSH-së për furnizimin e shërbimeve në lëmin e ndërtimit, respektivisht aplikimin e ngarkesës së kundërt (Reverse Charge) për TVSH, brenda vendit.

#### BAZA LIGJORE

Neni 52, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar përcakton personat e obliguar për të paguar TVSH, si në vijim:

*“1.4. Ministri i Financave mund të nxjerr akt nënligjor dhe të parasheh se personi i obliguar për të paguar TVSH-në është personi i tatueshëm për të cilin janë bërë cilado nga furnizimet në vijim:*

*1.4.1. furnizimi i punës ndërtimore, duke përfshirë riparimin, pastrimin, mirëmbajtjen, shërbimet e modifikimit dhe demolimit në lidhje me pasurinë e paluajtshme;*

*1.4.2. furnizimi nëse është i angazhuar personeli në aktivitetet e mbuluara me 1.4.1 të këtij paragrafi”.*

Neni 70, paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ Nr.03/2015 për zbatimin e Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, përcakton se:

*“Në përputhje me nenin 52, paragrafin 1, nënparagrafët 1.4.1 dhe 1.4.2 të Ligjit, person i obliguar për të paguar TVSH-në, është personi i tatueshëm për të cilin janë bërë cilido nga furnizimet në vijim:*

*1.1. Furnizimi i punës ndërtimore, duke përfshirë riparimin, pastrimin, mirëmbajtjen, shërbimet e modifikimit dhe demolimit në lidhje me pasurinë e paluajtshme;*

*1.2. Furnizimi nëse është i angazhuar personeli në aktivitetet e sipërshtënuara”.*

Neni 6 i Udhëzimit Administrativ MF - Nr. 06/2016 për plotësim ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015 për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, citojmë:

*1. Teksti në nenin 70, paragrafin 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015, fshihet dhe zëvendësohet, si në vijim:*

*2. Personat në skemën e posaçme të ndërtimtarisë janë personat e tatueshëm të cilët ofrojnë shërbime në lëmin e ndërtimtarisë për personat tjerë të tatueshëm.*

*2. Neni 70, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1. i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015, fshihet dhe teksti i nën paragrafit 3.2 bartet në paragrafin 3.*

*3. Neni 70, paragrafi 11 i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015, riformulohet si në vijim:*

*11. Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, të gjitha shërbimet ndërtimore (të evidentuara nga nën paragrafi 10.1 deri te nën paragrafi 10.11 të paragrafit 10 të këtij neni), të ofruara nga personi i tatueshëm për personin e tatueshëm, nga data e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, i nënshtrohen aplikimit të ngarkesës së kundërt brenda vendit, pavarësisht datës së lidhjes së kontratës apo aneks-kontratës.*

## **PËRKUFIZIME**

Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë Shpjegim Publik kanë kuptimin e njëjtë ashtu siç janë përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, si dhe Udhëzimet Administrative Nr. 03/2015 dhe Nr. 06/2016 për zbatimin e Ligjit për TVSH.

## **PERSONAT NË SKEMËN E POSAÇME TË NDËRTIMTARISË**

Personat në skemën e posaçme të ndërtimtarisë janë personat e tatueshëm të cilët ofrojnë shërbime në lëmin e ndërtimtarisë për personat tjerë të tatueshëm. Pra, personi i tatueshëm për nevoja të këtij Vendimi Shpjegues Publik konsiderohet, personi i cili është i regjistruar për qëllime të TVSH-së në Kosovë – Deklarues i TVSH-së.



## **APLIKIMI I NGARKESËS SË KUNDËRT PËR TVSH NË LËMIN E NDËRTIMTARISË**

Aplikimi i ngarkesës së kundërt në ndërtimtari vlen vetëm për personat e tatueshëm të cilët janë pjesë e transaksionit (furnizuesi dhe pranuesi i shërbimit). Pra, furnizuesi dhe pranuesi i shërbimit duhet të jenë Deklarues të TVSH-së në Kosovë.

Ngarkesa e kundërt aplikohet në furnizimin e shërbimeve ndërtimore. Gjithashtu, ngarkesa e kundërt aplikohet edhe në rastet e furnizimit të përzier, kur në të njëjtin transaksion furnizohen shërbime dhe mallra, pavarësisht prej proporcionit në mes tyre.

Transaksioni nuk i nënshtrohet aplikimit të ngarkesës së kundërt, në rastet kur:

1. Furnizimi i mallrave nuk shoqërohet edhe me furnizim të shërbimit;
2. Njëri nga palët në transaksion (ofruesi ose pranuesi i shërbimit) nuk është person i tatueshëm – Deklarues i TVSH-së;

## **NGARKESA E KUNDËRT E TVSH-SË**

Sipas skemës së ngarkesës së kundërt (në tekstin e mëtejme Skema e veçantë), për furnizimin e shërbimeve të cilat kanë të bëjnë në lëmin e ndërtimit, obligimi i pagesës së TVSH-së bartet tek personi i tatueshëm, i regjistruar për TVSH në Kosovë, për të cilin janë kryer furnizimet.

Skema e veçantë ka të bëjë me punët ndërtimore në ndërtimin e objekteve të reja si dhe punimet për renovimin, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese.

## **PAGESA E TVSH-SË**

Sipas nenit 52, nënparagrafit 1.4 të Ligjit, personi i obliguar për të paguar TVSH-në është personi i tatueshëm të cilit i janë furnizuar punët ndërtimore (pranuesi i shërbimit), duke përfshirë riparimin, pastrimin, mirëmbajtjen, shërbimet e modifikimit dhe demolimit në lidhje me pasurinë e paluajtshme.

## **FATURIMI**

Përmbajtja e faturave të lëshuara nga personi i tatueshëm për personin e tatueshëm duhet të jetë në përputhje me nenin 45 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH.

Sipas skemës së veçantë, furnizuesi, edhe pse nuk është i obliguar të paguajë TVSH-në, ai është i obliguar të lëshoj faturë tatimore.

Furnizuesi duhet të cekë në faturë se pranuesi i shërbimit është i obliguar të paguajë TVSH-në duke e vendosur referencën e nenit 52, paragrafit 1, nënparagrafit 1.4 të Ligjit apo ndonjë referencë tjetër që tregon se furnizimi i nënshtrohet procedurës së ngarkesës së kundërt. Teksti në vijim do të konsiderohet si i duhur: *“Ngarkesa e kundërt, nënparagrafi 1.4.1 ose 1.4.2 i nenit 52 të Ligjit për TVSH në Kosovë”*.



## LLOGARITJA E TVSH-SË

Pranuesi i furnizimit duhet të llogarisë TVSH-në mbi të dhënat e faturës së pranuar nga furnizuesi.

## LINDJA E DETYRIMIT PËR TË NGARKUAR TVSH-NË

Lindja e detyrimit për të ngarkuar TVSH-në përcaktohet në nenin 22 të Ligjit për TVSH, si në vijim:

1. Momenti i lindjes së detyrimit ndodhë dhe TVSH-ja bëhet e ngarkueshme kur bëhet furnizimi i mallrave dhe shërbimeve.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, rregullat specifike në rastin e pasqyrave të njëpasnjëshme të llogarive ose pagesave pasuese janë si vijon:

2.1. kur të kemi pasqyra të njëpasnjëshme të llogarive ose pagesa të njëpasnjëshme, furnizimi i mallrave ndryshe nga ai i përbërë nga dhënia me qira e mallrave për një periudhë të caktuar ose nga shitja e mallrave me kushte të shtyrjes, sikur që është referuar në nën-paragrafin 2.2., të paragrafit 2, të nenit 10 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH ose furnizimi i shërbimeve duhet të konsiderohet sikurse është kryer me përfundimin e periudhave për të cilat lidhen pasqyrat e llogarive apo pagesat;

2.2. furnizimi i vazhdueshëm i mallrave dhe shërbimeve gjatë një periudhe kohore duhet të konsiderohet se është përfunduar në intervalet prej një (1) muaji;

2.3. kontratat afatgjata, përfshirë këtu kontratat ndërtimore afatgjata dhe kontratat afatgjata të instalimit, duhet të konsiderohen si të përfunduara:

2.3.1. në muajin e lëshimit të situacionit, por jo më larg se një muaj pas lëshimit të situacionit në rastet kur pranimi teknik i punëve bëhet më vonë;

2.3.2. në rastet kur gjatë vitit janë lëshuar një apo më shumë situacione, në fund të vitit kërkohet që të lëshohet një situacion i cili do të bazohet në matjen reale të punëve të kryera, ose;

2.3.3. nëse gjatë vitit nuk lëshohet asnjë situacion, atëherë në fund të vitit do të lind detyrimi për të ngarkuar TVSH bazuar në matjen reale të punëve të kryera.

3. Pagesat e pranuar ose lëshimi i faturave rregullohet si vijon:

3.1. kur pagesa duhet të bëhet apo është bërë në llogari para se mallrat dhe shërbimet të jenë furnizuar, TVSH-ja duhet të bëhet e ngarkueshme në pranimin e pagesës dhe në shumën e pranuar;

3.2. Kur fatura lëshohet para se mallrat dhe shërbimet të jenë furnizuar, TVSH-ja do të bëhet e ngarkueshme në momentin kur është lëshuar fatura.



## **E DREJTA E ZBRITJES SË TVSH-SË**

Personi i tatueshëm, subjekti i këtij Vendimi Shpjegues, mund të zbres nga obligimet e tij të TVSH-së, obligimin e TVSH-së apo TVSH-në e paguar në lidhje me blerjet e mallrave ose shërbimeve, me kusht që ai të ketë shfrytëzuar apo do të shfrytëzojë ato mallra ose shërbime për qëllime të transaksioneve të tij të tatueshme.

Për mallrat dhe shërbimet e shfrytëzuara ose që do të shfrytëzohen nga personi i tatueshëm, për të cilat mund të zbritet TVSH-ja dhe për transaksionet për të cilat nuk duhet të zbritet TVSH-ja, zbritet vetëm ajo pjesë e TVSH-së që i atribuohet transaksionit të tatueshëm. Pjesa e TVSH-së së zbritshme duhet të përcaktohet në pajtueshmëri me nenin 39 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH.

## **DEKLARIMI I TVSH-SË**

Pranuesi i shërbimit, në formularin e TVSH-së duhet të përfshijë TVSH-në e llogaritur mbi blerjet e shërbimeve në lëmin e ndërtimit që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt, të ofruara nga furnizuesi.

## **SHËRBIMET NË LËMIN E NDËRTIMIT QË I NËNSHTROHEN NGARKESËS SË KUNDËRT TË TVSH-SË**

Shërbime në lëmin e ndërtimit, përfshirë riparimin, pastrimin, mirëmbajtjen, shërbimet e modifikimit dhe demolimit në lidhje me pasurinë e paluajtshme, sipas nenit 70 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015 për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, kuptohen:

- a. Shërbimet e projektimit dhe punët tjera në lidhje me objektin ndërtimor;
- b. Punët përgatitore në vendpunishte, punët për rrënim të objektit apo pjesëve të tij;
- c. Ndërtimi i objekteve ndërtimore dhe i pjesëve të tyre;
- d. Punët e instalimit;
- e. Punët përfundimtare ndërtimore;
- f. Mirëmbajtja, rinovimi dhe meremetimi i objektit apo pjesëve të tij, përfshirë pastrimin, vendosjen e qeramikave, tapetave dhe punët e parketit;
- g. Ofrimi i shërbimeve të mbikëqyrjes;
- h. Vendosja apo montimi i pajisjeve apo makinerisë të cilat pas vendosjes dhe montimit bëhen pasuri e paluajtshme;
- i. Dhënia me qira e mjeteve dhe pajisjeve për ndërtim apo rrënim, me përdoruesin e tyre;
- j. Të gjitha shërbimet tjera të cilat përfshijnë furnizimin e luajtshmërisë dhe përfshirjen e tyre në ndërtim, ashtu që luajtshmëria krijon cilësi të paluajtshmërisë;
- k. Angazhimi i personelit, nëse personeli kryen shërbime ndërtimore.

Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, të gjitha shërbimet ndërtimore (të evidentuara nga pika “a” deri tek pika “k”), të ofruara nga personi i tatueshëm për personin e tatueshëm, nga data e hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2016, i nënshtrohen aplikimit të ngarkesës së kundërt brenda vendit, pavarësisht datës së lidhjes së kontratës apo aneks-kontratës.

Për më shumë lidhur me shërbimet në lëmin e ndërtimit, mund të shfrytëzohet Kodi – Klasifikimi i Veprimtarive Ekonomike (NACE Rev.2), Sektori F – Ndërtimtaria.

### **SHEMBULL Nr. 1**

Kompania “A” (investitor) person i tatueshëm në Kosovë, më 10 Dhjetor 2016, angazhon kompaninë “B” (punëkryes) person i tatueshëm në Kosovë, për kryerjen e punëve përfundimtare të ndërtimit në objektin që financohet prej tij, në vlerë prej 177,000€ (furnizimi i tatueshëm = 150,000€ dhe 18% TVSH = 27,000€).

Punëkryesi “B”, për kryerjen e këtyre punimeve angazhon kompaninë “C” (nënkontraktor) në vlerë prej 118,000€ (furnizimi i tatueshëm = 100,000€ dhe 18% TVSH = 18,000€) e cila, për punimet e kryera i faturon punëkryesit “B”.

Pas përfundimit të punimeve, Kompania “A” (investitori) shet objektin në shumë të tatueshme 200,000€.

### **TRAJTIMI TATIMOR PËR TVSH - PËRMES NGARKESËS SË KUNDËRT:**

#### **A. Deklarimi nga Kompania “C” (Nënkontraktori):**

Sipas dispozitave të nenit 52, nënparagrafit 1.4. të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, kompania „C“ nuk do të llogaritet TVSH në këtë shërbim sepse obligimi për pagesë të TVSH-së kalon në pranuesin e shërbimit, pra në kompaninë „B“.

Regjistrimet në formularin e deklarimit dhe pagesës së TVSH-së:

Nr.	Emërtimi	Shitjet
[10]	Shitjet e liruara me të drejtë kreditimi	100,000.00€

Ndërsa blerjet për të cilat gëzon të drejtën e zbritjes së TVSH-së i regjistron në rubrikën gjegjëse të blerjeve.





## B. Deklarimi nga Kompania "B" (Punëkryesi):

Sipas dispozitave të nenit 52, nënparagrafit 1.4. të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, kompania „B“ nuk do të llogaritë TVSH në këtë shërbim sepse obligimi për pagesë të TVSH-së kalon në pranuesin e shërbimit, pra në kompaninë „A“.

Regjistrimet në formularin e deklaramit dhe pagesës së TVSH-së:

Nr.	Emërtimi	Shitjet		TVSH e llogaritur
[10]	Shitjet e liruara me të drejtë kreditimi	150,000.00€		
[28]	Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt me normë 18%	100,000.00€	[29]	18,000.00€

Nr.	Emërtimi	Blerjet		TVSH e zbritshme
[65]	E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	100,000.00€	[66]	18,000.00€
[72]	TVSH që duhet të paguhet	0.00€		

## C. Deklarimi nga Kompania "A" (Investitori):

a) Nëse investitori ofron vetëm furnizime të tatueshme  
(e drejta e zbritjes së TVSH-së 100%)

Regjistrimet në formularin e deklaramit dhe pagesës së TVSH-së:

Nr.	Emërtimi	Shitjet		TVSH e llogaritur
[12]	Shitjet e tatueshme me normën 18%	200,000.00€	[13]	36,000.00€
[28]	Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt me normë 18%	150,000.00€	[29]	27,000.00€

Nr.	Emërtimi	Blerjet		TVSH e zbritshme
[65]	E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	150,000.00€	[66]	27,000.00€
[72]	TVSH që duhet të paguhet	36,000.00€		



- b. Nëse investitori ofron furnizime të tatueshme dhe furnizime të liruara (70% furnizime të tatueshme, ndërsa 30% furnizime të liruara pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së).**

Regjistrimet në formularin e deklarimit dhe pagesës së TVSH-së:

Nr.	Emërtimi	Shitjet		
[9]	Shitjet e liruara pa të drejtë kreditimi	60,000.00€		TVSH e llogaritur
[12]	Shitjet e tatueshme me normën 18%	140,000.00€	[13]	25,200.00€
[28]	Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt me normë 18%	150,000.00€	[29]	27,000.00€

Nr.	Emërtimi	Blerjet		
[33]	Blerjet, Importet me TVSH jo të zbritshme	53,100.00€		TVSH e zbritshme
[65]	E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	105,000.00€	[66]	18,900.00€
[72]	TVSH që duhet të paguhet	33,300.00€		

- c. Nëse investitori ofron vetëm furnizime të liruara pa të drejtë kreditimi të TVSH-së**

Regjistrimet në formularin e deklarimit dhe pagesës së TVSH-së:

Nr.	Emërtimi	Shitjet		
[9]	Shitjet e liruara pa të drejtë kreditimi	200,000.00€		TVSH e llogaritur
[28]	Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt me normë 18%	150,000.00€	[29]	27,000.00€

Nr.	Emërtimi	Blerjet
[33]	Blerjet, Importet me TVSH jo të zbritshme	177,000.00€
[72]	TVSH që duhet të paguhet	27,000.00€



## SHEMBULL Nr. 2

Investitori angazhon punëkryesin për ndërtimin e objektit të depos dhe ka pranuar faturën prej furnizuesit (kontraktorit/punëkryesit) në vlerë prej 100,000€ dhe në vend të TVSH-së është e shkruar: "Ngarkesa e kundërt, nën paragrafi 1.4 i nenit 52 të Ligjit për TVSH në Kosovë"

### a. Nëse investitori ofron furnizime vetëm të tatueshme (Depon e përdor për furnizime 100% të tatueshme)

Regjistrimet në formularin e deklaramit dhe pagesës së TVSH-së:

Nr.	Emërtimi	Shitjet		TVSH e llogaritur
[28]	Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt me normë 18%	100,000.00€	[29]	18,000.00 €

Nr.	Emërtimi	Blerjet		TVSH e zbritshme
[32]	Blerjet dhe importe investive pa TVSH	100,000.00€		
[65]	E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	100,000.00€	[66]	18,000.00 €
[72]	TVSH që duhet të paguhet	0.00 €		

### b. Nëse investitori ofron furnizime të tatueshme dhe furnizime të liruara (Furnizime të përziera p.sh. 70% me TVSH, 30% të liruara nga TVSH)

Nr.	Emërtimi	Shitjet		TVSH e llogaritur
[28]	Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt me normë 18%	100,000.00€	[29]	18,000.00 €

Nr.	Emërtimi	Blerjet		TVSH e zbritshme
[32]	Blerjet dhe importe investive pa TVSH	70,000.00 €		
[34]	Blerjet dhe Importet investive me TVSH jo të zbritshme	35,400.00 €		
[65]	E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	70,000.00 €	[66]	12,600.00 €
[72]	TVSH që duhet të paguhet	5,400.00 €		

**c. Nëse investitori ofron vetëm furnizime të liruara nga TVSH pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së (Depon e përdor vetëm për furnizime te liruara nga TVSH)**

Nr.	Emërtimi	Shitjet	TVSH e llogaritur
[28]	Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt me normë 18%	100,000.00€	[29] 18,000.00€

Nr.	Emërtimi	Blerjet
[34]	Blerjet dhe Importet investive me TVSH jo të zbritshme	118,000.00€
[72]	TVSH që duhet të paguhet	18,000.00€

**HYRJA NË FUQI**

Ky Vendim Shpjegues Publik zbatohet nga data e hyrjes në fuqi e Udhëzimit Administrativ MF - Nr. 06/2016 për plotësim ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015 për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, si dhe shfuqizon Vendimin Shpjegues Publik nr. 01/2016 të datës 24 Shkurt 2016.

Data: 21 / 12 /2016

Sakip Imeri  
Drejtor i Përgjithshëm i ATK